

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 7 KORRIK 2022

Nuk ka dyshim që edhe ne jemi dakord për ndryshimin e rendit të ditës dhe për vendosjen me procedurë të përshpejtuar të dy protokolleve të aderimit të dy vendeve si pjesë e NATO-s jo vetëm si një shprehje e vullnetit politik, por edhe për më shumë se sa kaq. Situata, në të cilën është duke kaluar thuajse planeti tashmë, është e tillë që e bën rëndësinë e NATO-s si një nga elementet kyçe të garancisë dhe garantimit të të drejtave dhe lirive të njerëzve, por edhe të sigurisë në këtë planet. Kështu që, pa dyshim, si gjithmonë, Grupi Parlamentar i PD-së shprehet pro që të futen në rendin e ditës, madje po ju them edhe sot, që tani, në këtë moment, votën tonë pro për këto dy protokolle. Në fakt, unë kisha edhe një kërkesë tjetër, e nderuar zonja Kryetare, të cilën po e shpreh tani.

Që në datën 27 maj kemi paraqitur një projektrezolutë për një mocion me debat lidhur me dënimin e gjenocidit serb në Kosovë. U bë e disata herë që jua kërkoj qoftë në Konferencës e Kryetarëve, qoftë edhe në seancën plenare. Ashtu si vullneti ynë pro për dy protokollat për aderimin e dy vendeve në NATO, nën frymën e ruajtjes së vlerave kryesore të individit, lirive dhe të të drejtave themelore, të ndëshkimit me vullnet politik, sidomos nga ky parlament i të gjithë agresorëve, besoj se është një detyrim i çdokujt prej nesh këtu, juaji, së pari, si Kryetare e parlamentit, që të mos e shtyni dhe të mos e zvarrisni, siç ka ndodhur deri tani, atë rezolutë që kemi kërkuar ne. Por ne sot do të shqyrtojmë dhe do të diskutojmë edhe një projektrezolutë të paraqitur nga Grupi Parlamentar i PS-së “Për dënimin e gjenocidit në Srebrenicë”.

E kemi detyrim jo vetëm për vendin ku jemi, për rajonin, por është një detyrim akoma më i madh ai që ne kemi kërkuar, që, ashtu siç do të duhet të shprehim vullnetin tonë pro edhe në rastin e Srebrenicës, e kemi një detyrim akoma edhe më të madh për gjakun tonë, për shqiptarët e Kosovës. Asnjëherë nuk ka për të qenë vonë për ta thënë e për ta rifreskuar atë se çfarë njerëzit tanë, vëllezërit tanë, gjaku ynë ka hequr në Kosovë. Është e njëjta situatë, është i njëjti agresor, ndoshta edhe më e rëndë se sa kaq, dhe nuk e kuptoj, të them të drejtën, këtë

indiferencën tuaj, zvarritjen tuaj për ta diskutuar këtu si një shenjë vullneti e jo hipokrite për të dënuar gjenocidin serb në Kosovë. Nga data 27 maj, deri në datën 27 qershor, siç thotë edhe Rregullorja, do të duhej që ai mocion debati të ishte zhvilluar. Realisht nuk e kuptoj se cili është ai motiv, ai shkak, ajo arsye, ndoshta ajo forcë, që ju pengon ju për të zbatuar Rregulloren.

Kështu pra, zonjë, siç edhe ndryshuat rendin e ditës sot, për të cilin ne dhanë votën tonë pro, do të duhet që sot të futet në rendin e ditës edhe projektrezoluta e kërkuar nga ne që në datën 27 maj. Pres që ta hidhni në votë dhe ta miratoni. Faleminderit!